



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1121/1 Prot.

Tiranë, më 01.08.2024

V E N D I M

Nr. 210, Datë 01.08.2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 99, datë 14.05.2024, e bërë nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të verbërit” kundër Këshillit të Qarkut Durrës, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Me datë 24.11.2023, i jemi drejtuar Këshillit të Qarkut Durrës me një kërkesë për të finacuar Projekt-Buxhetin e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” për vitin 2024. Në këtë projekt buxhet janë parashikuar nevojat e domosdoshme për të kryer aktivitetet apo punët që shoqata ka marë përsipër për ti ofruar personave të verbër, anëtarë të saj.

Këshilli i Qarkut Durrës na ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 157/1, datë 09.04.2024, ku shkruhet se: “Ju bëjmë me dije se nga ana jonë e kemi të pamundur financimin për Shoqatën tuaj për vitin 2024, sepse aktualisht Këshilli i Qarkut ka detyrime të prapambetura për të paguar dhe fondet e transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta që Këshilli i Qarkut realizon gjatë vitit, nuk mjaftojnë për të bërë financime të tilla”.

Pra do të thotë se nuk ka asnjë financim për shoqatën tonë edhe pse në bazë të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar, neni 13, shteti financon Shoqatën e të Verbërve sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim. Në këto kushte Këshilli i Qarkut nuk ka marë parasysh as ligjin nr. 8098/1996, të ndryshuar dhe as udhëzimet që jepen nga Konventa për të Drejtat e PAK, duke na lënë pa mbështetje financiare, duke krijuar barriera për mos funksionimin e organizatës. Me këtë veprim na hiqet e drejta për të përfituar nga të mirat materiale që krijohen nga Qeveria për qytetarët e saj”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe eliminimin e pasojave që vjen për shkak të këtij diskriminimi.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me Vendimin nr. 6179, datë 07.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, Shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj të verbër.

Bazuar në ankesën e paraqitur pala ankuese, Shoqata, pretendon se është cenuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, si person juridik, pasi trajtohet në mënyrë të padrejtë, duke mos përfituar financim për ushtrimin e veprimtarisë së saj, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar.

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar për sa kohë që dispozitat ligjore nëpërmjet të cilave Shoqata është përfituese në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk zbatohen nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës.

Bazuar në nenin 32, pika 1/a, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet:

“1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”.....”

Bazuar në nenin 4, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet:

1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare”.

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“Palë” është: çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;

një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës.

Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi”.

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:

- a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;*
- b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedurës administrative;*
- c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”.*

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë*

pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 7 të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a publikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, apo në raport me të drejtat e tyre ligjore.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD-së dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të LMD.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 719/1, datë 22.05.2024, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Këshilli i Qarkut Durrës, për ankesën e bërë, si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Parashtrime dhe kopje të korrespondencës zyrtare të mbajtur me Shoqatën Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”.
 - Sa është numri i organizatave joqeveritare, që kanë përfituar mbështetje financiare nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës, për vitin 2024. Nëse ka, kopje të plotë të procedurës dhe vendimmarrjes.
 - Informacion nëse ka organizata të tjera joqeveritare të cilat kanë paraqitur pranë Këshillit të Qarkut Durrës, kërkesë për mbështetje financiare, gjatë periudhës së viteve 2020-2023. Nëse po, kopje të procedurës së ndjekur lidhur me trajtimin e çdo rasti.
 - Cila është procedura ligjore/praktika që ndjek Këshilli i Qarkut Durrës, lidhur me kërkesat e një organizate joqeveritare për mbështetje financiare dhe sa fonde ka të parashikuara Këshilli i Qarkut Durrës, për vitin 2024, për mbështetjen e këtyre organizatave.

Me shkresën nr. 262/1, datë 31.05.2024, Këshilli i Qarkut Durrës, dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Duke marrë në shqyrtim kërkesën për mbështetje financiare, dëshirojmë t’ju informojmë se Këshilli i Qarkut Durrës vlerëson punën

dhe angazhimin e Shoqatës në shërbim të komunitetit të të verbërve. Megjithatë, për shkak të pamundësisë financiare, bazuar dhe në kushtet dhe rrethanat që ndodhet Institucioni i Këshillit të Qarkut Durrës, nuk mund ta mbështesim kërkesën për mbështetje financiare për vitin 2024. Situata jonë financiare është e rënduar nga një listë e gjatë e kreditorëve, që na ka bërë të pamundur përmbushjen e kërkesës suaj.

Në lidhje me pretendimet e subjektit aplikues, ne argumentojmë se, sipas Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, institucionet lokale janë të detyruara të menaxhojnë financat e tyre në mënyrë të përgjegjshme dhe të respektojnë prioritetet financiare. Detyrimi ynë primar është shlyerja e detyrimeve të papaguara ndaj kreditorëve dhe menaxhimi i buxhetit në mënyrë të qëndrueshme. Në këtë kontekst, nuk kemi mundur të përmbushim kërkesën për mbështetje financiare të Shoqatës “Shpresë për të Verbërit”.

Sa i përket numrit të organizatave joqeveritare që kanë përfituar mbështetje financiare nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës për vitin 2024, dëshirojmë të konfirmojmë se nuk ka asnjë organizatë që ka përfituar mbështetje financiare nga institucioni ynë për këtë vit.

Sqarojmë se në Ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996, neni 13, sanksionohet se:

- “Shteti mbron dhe përkrah Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë. Ai i njeh asaj rolin aktiv në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve, duke e trajtuar si palë konsultative në hartimin e ligjeve e akteve nënligjore, si dhe zgjidhjen e problemeve të të verbërve.*
- Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim.*
- Shteti vë në dispozicion të Shoqatës së të Verbërve mjedise pune në qendër dhe në rrethe, të cilat ua jep në përdorim”.*

Pra, ligji e ka parashikuar qartë, që për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve, duke e trajtuar si palë konsultative në hartimin e ligjeve e akteve nënligjore, si dhe zgjidhjen e problemeve të të verbërve e ka si rol aktiv “Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë” dhe vijon më poshtë:

- Shteti financon veprimtarinë e “Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë”, sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim.*

Këshilli i Qarkut Durrës nuk ka marrë buxhet nga shteti për këtë qëllim, pasi këto fonde i merr “Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë”.

Në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi numrin e organizatave joqeveritare që kanë përfituar mbështetje financiare nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës për vitin 2024, ju informojmë se për shkak të pamundësisë financiare, Këshilli i Qarkut Durrës nuk ka mbështetur asnjë organizatë joqeveritare gjatë këtij viti.

Gjithashtu, ju njoftojmë se nuk ka procedurë apo vendimmarrje në lidhje me shpërndarjen e mbështetjes financiare për organizatat joqeveritare për vitin 2024, duke qenë se një mbështetje e tillë nuk është ofruar.

Në lidhje me organizatat e tjera joqeveritare që kanë paraqitur kërkesa për mbështetje financiare gjatë periudhës 2020-2023, për shkak të konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe në bazë të nenit 17, të Ligjit nr. 119, datë 18.09.2014, paragrafi 3, ku citohet: “3. E drejta e informimit kufizohet, nëse është e domosdoshme, proporcionale dhe në qoftë se përhapja e informacionit do të shkelte sekretin profesional të garantuar nga ligji.”, nuk mund të vendosim në dispozicion procedurën specifike të ndjekur për trajtimin e tyre apo secilës prej tyre. Megjithatë, mund të sigurojmë se procedura për këtë periudhë është e njëjtë me atë të kthimit të përgjigjes së Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, e cila është bërë me shkresën nr. 157/1, datë 09.04.2024.

Këshilli i Qarkut Durrës, për vitin 2024, për shkak të pamundësisë financiare, nuk ka të ardhura që të shkojnë për mbështetjen e organizatave. Duhet cituar gjithashtu që Këshilli i Qarkut Durrës është një organ vetëqeverisës i cili i harton vetë politikat e saj në përputhje me ligjin, buxhetin dhe me nevojat e komunitetit që ka. Vlen të theksohet se Këshilli i Qarkut Durrës ka mbështetur Shoqatën në momente që ka pasur mundësi financiare, gjë që është bërë e pamundur për shkak të pamundësisë financiare.

Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996, neni 13, ka përcaktuar qartësisht se kush shoqatë e merr mbështetjen nga shteti, ku ligji cakton “Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë” dhe jo të gjitha shoqatat/organizatat jofitimprurëse apo grupime të tjera që mund të krijohen në bazë të ligjit nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, që mbrojnë interesa të njëjta.

Këshilli i Qarkut Durrës është institucion vetëqeverisës dhe nuk e ka për tagër ligjor që të mbështesë organizatat jofitimprurëse. Në varësi të nevojave të komunitetit dhe buxhetit që ajo ka, mund të mbështesë organizata apo organizatat jofitimprurëse, por jo detyrimisht. Mbi të gjitha momentalisht Këshilli i Qarkut Durrës nuk po mbështet asnjë organizatë jofitimprurëse. Pra humbet “qëllimi”, sepse mund të ketë dhe organizata të tjera jofitimprurëse që mbrojnë minoritete të caktuara dhe kjo nuk është detyrë apo tagër i Këshillit të Qarkut Durrës që ti mbështesë ato.

Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, të drejtohet tek “Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë”, pasi shteti i njej dhe ju jep mbështetje financiare, dhe nuk i jep fonde Këshillit të Qarkut në fjalë për ti shpërndarë ato në organizata jofitimprurëse të tjera.

Ju sqarojmë se bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 24, pika 1, përcaktohet se: “Bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, femrat, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit, etj, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”.

Rekomandojmë që Shoqata të aplikojë për grante për projekte që promovojmë të drejtat e njeriut dhe përfshirjen sociale, duke ju drejtuar: Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Organizatave ndërkombëtare, ambasadave të huaja dhe Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri”.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit e transparencës, për një gjykim sa më të drejtë të çështjes, Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, nëpërmjet shkresës nr. 719/3, datë 10.06.2024, është njohur me përgjigjen e Këshillit të Qarkut Durrës.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit.

Në ankesën e depozituar nga ana e Shoqatës, pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, të verbër nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës, përmes mosnjohjes së të drejtës për të financuar buxhetin e veprimtarisë së Shoqatës, Dega Durrës për vitin 2024.

Lidhur me këtë moment, Komisioneri ka analizuar dispozitat ligjore që normojnë të drejtën e personave me aftësi të kufizuar/të verbër, për të përfituar mbështetje me burime financiare nga shteti për veprimtarinë e tyre.

Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar.

“Neni 13

Shteti mbron dhe përkrah Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë.

Ai i njeh asaj rolin aktiv në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të verbërve, duke e trajtuar si palë konsultative në hartimin e ligjeve e akteve nënligjore, si dhe zgjidhjen e problemeve të të verbërve.

Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim.

Shteti vë në dispozicion të Shoqatës së të Verbërve mjedise pune në qendër dhe në rrethe, të cilat ua jep në përdorim”.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

“Neni 77

Detyrat dhe kompetencat e këshillit të qarkut.

Këshilli i qarkut ushtron këto kompetenca dhe detyra:

- a. zgjedh nga përbërja e vet komisionet e këshillit dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit të vet;
- b) zgjedh nga anëtarët e këshillit kryetarin, zëvendëskryetarin dhe anëtarët e kryesisë, duke respektuar ligjin për barazinë gjinore, dhe i shkarkon ata;
- c) emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit të qarkut;
- ç) miraton strukturën, organikën dhe kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së qarkut, të njësive e të institucioneve buxhetore në varësi të qarkut, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare dhe të personave të tjerë juridikë që krijon vetë ose me të cilët është bashkë-themelues;
- dh) miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij;
- e) miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve;
- ë) organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm;
- f) vendos për taksat e tarifat në kompetencë të qarkut, si dhe për nivelin e tyre;
- g) vendos për marrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve;
- gj) vendos për krijimin e një personi juridik me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore, përfshirë subjektin e kompetencave të përbashkëta, sipas nenit 14 të këtij ligji;
- h) emëron dhe shkarkon drejtuesit e ndërmarrjeve dhe të institucioneve në varësi të tij;
- i) vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- j) vendos për vërtetimin dhe heqjen e mandatit të këshilltarit të qarkut, sipas nenit 75 të këtij ligji;
- k) miraton norma, standarde e kritere për rregullimin e disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik në nivel qarku;
- l) vendos për simbolet e qarkut;
- ll) jep tituj nderi dhe stimuj;
- m) vendos për rregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe në zbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim në qark;
- n) miraton ose shfuqizon vendimet e kryesisë së këshillit të qarkut.

Nga aktet shkresore të depozituara nga palët rezulton se, Shoqata “Shpresë për të Verbërit” me shkresën datë 30.11.2023, bazuar në nenin 13 të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996, “Për statusin e të verbërit”, ka kërkuar nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës, financimin e projekt buxhetit për vitin 2024, për Degën e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” Qarku Durrës, në vlerën 5.632.400 lekë.

Këshilli i Qarkut Durrës me shkresën nr. 157/1, datë 09.04.2024, ka informuar Shoqatën se: “... ju bëjmë me dije se nga ana jonë e kemi të pamundur financimin e Shoqatës tuaj për vitin 2024, sepse aktualisht Këshilli i Qarkut ka detyrime të prapambetura për të paguar dhe fondet e

transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta që Këshilli i Qarkut realizon gjatë vitit nuk mjaftojnë për të bërë financime të tilla... ”.

Në kushtet që nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës nuk është miratuar financimi i buxhetit për vitin 2024 të Shoqatës Dega Durrës, Shoqata i është drejtuar me ankesë me pretendim diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se personat me aftësi të kufizuara, të verbër janë të organizuar në disa organizata jofitimprurëse, kështu rezulton se:

- Me Vendimin nr. 2749, datë 10.04.1996, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, është regjistruar si person juridik, *“Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë”*, e cila është një organizatë jofitimprurëse e krijuar me qëllim mbrojtjen e interesave të të verbërve në Republikën e Shqipërisë.
- Me Vendimin nr. 6179, datë 07.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është regjistruar si person juridik, Shoqata *“Shpresë për të Verbërit”*, e cila është një organizatë jofitimprurëse, që ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj të verbër.

Referuar legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri vlerëson se bazuar në detyrat dhe kompetencat e këshillit të qarkut, rezulton se Këshilli i Qarkut Durrës nuk ka detyrimin ligjor për të bërë financimin e veprimtarisë së *“Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë”* dhe as të Shoqatës *“Shpresë për të verbërit”*, por bazuar në situatën financiare të institucionit mund të miratojë vendimmarrje për mbështetje financiare të aktiviteteve të organizatave jofitimprurëse.

Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 *“Për Statusin e të Verbërit”*, i ndryshuar, në Nenin 13, të tij ka përcaktuar se: “..Shteti financon veprimtarinë e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë sipas burimeve financiare të planifikuara për këtë qëllim”.

Pra, bazuar në ligjin sipërcituar, shteti njeh si autoritetet përgjegjës dhe zyrtar për financimin e veprimtarisë, vetëm Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, rezulton se Këshilli i Qarkut Durrës për vitin 2024, nuk ka mbështetur financiarisht asnjë organizatë jofitimprurëse.

Sa më sipër, bazuar në faktet dhe provat e administruara dhe në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, Shoqata Kombëtare *“Shpresë për të Verbërit”*, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës, për shkak të aftësisë së kufizuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të Shoqatës Kombëtare “*Shpresë për të Verbërit*”, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA